



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Dragas Municipality



- Kuvendi Komunal Dragash

01 Nr.060/01-19926/1

Dt.28.10.2020

D r a g a s h

Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neneve 5 e 6 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme të Komunës, nenit 5 të Rregullores për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme të Komunës dhe nenit 32 të Statutit të Komunës së Dragashit, pas shqyrtimit paraprak të Kërkesës së KOSTT-it për ndryshimin-plotësimin e Vendimit të Kuvendit Komunal të Dragashit 01 Br.06-2025/2 të dt.18.02.2012 për sigurimin e lokacionit për ndërtimin e e nënstacionit 110/35/10(20) kV Dragash. në seancën e Kuvendit Komunal të Dragashit të dt.28.10.2020, miratohet ky:

V E N D I M

I. APROVOHET Kërkesa e KOSTT-it për ndryshimin-plotësimin e Vendimit të lartëcekur të Kuvendit Komunal të Dragashit 01 Nr.06-2025/2 të dt.18.02.2012, për ndarjen e pronës shoqërore në vendin e qujtur "Dubrava" parc.kadastrale 570 ZK Shajne në vendin "Dubrava-Sollake-Tuplan", që evidentohet sipas listës poseduese 298 ZK Shajne, në emër të "Pronës shoqërore-Kuvendi Komunal", me sipërfaqe prej 7000 m², me afatin prej 99 vjetëve të shfrytëzimit (në vend të 40 vjetëve, sipas Vendimit paraprak)

II. Obligohet Komisioni i themeluar i Kuvendit Komunal të Dragashit që, para lëshimit të Aktvendimit për lejimin e shfrytëzimit, matjeve gjeodezike, verifikimit të koordinatave të parcelës dhe bartjes në librat kadastrale të sipërfaqes së përmendur në pikën I të këtij Vendimi, përmes Drejtoratit të Urbanizmit, Katastrit dhe Mbrotjtjes së Mjedisit, përkatësisht Shërbimit Pronëso-Juridik, që të sigurohet Pëlqimi i ministrive kompetente në harmoni me nenet 5 e 6 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtëshme të Komunës dhe nenin 5 të Rregullores së sipërpërmendur.

III. Për masat e ndërmarra të njoftohet Kuvendi Komunal dhe kryetari Komunës.

A r s y e t i m

Duke u pasur parasysh arsyet e dhëna në Kërkesën e KOSTT-it për ndryshim-plotësim të Vendimit të mëparshëm të Kuvendit Komunal të Dragashit, për vazhdim të afatit të shfrytëzimit (nga 40 në 99 vjet), si dhe interesit të Komunës dhe qytetarëve për rëndësinë e investimeve, Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.28.10.2020, vendosi për aprovimin e Vendimit, si në pikat I e II të këtij Vendimi.

Shtojcë: Vendimet e Kuvendit Komunal Dragash...dhe Kërkesa e KOSTT-it...

I dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit...,
- KOSTT-it Prishtinë,
- Drejtoratit të Urbanizmit...,drejtorit z.Bean Haxhihasan,
- Kryetarit të Komunës Dragash z.Shaban Shabani, dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH
Kryesuesi
Betim Merdiu